PSH.nr.918/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Nuhi Paçarizi - Kryetar, Blerim Dina - Referues, Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "Ora Engineering" SH.P.K. – Prishtinë, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull "Furnizim me pjesë rezervë për MRK", me nr. të prokurimit: KEK-20-778-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – "KEK" sh.a., më datë: 23.11.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: "Ora Engineering" SH.P.K. – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me pjesë rezervë për MRK", me nr. të prokurimit: KEK-20-778-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – "KEK" sh.a.

II. **ANULOHET**, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: "Furnizim me pjesë rezervë për MRK", me nr. të prokurimit: KEK-20-778-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – "KEK" sh.a, dhe lënda kthehet në **rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "Ora Engineering" SH.P.K. – Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues "Ora Engineering" SH.P.K. – Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 10.11.2020 me nr. 918/20, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull "Furnizim me pjesë rezervë për MRK", me nr. të prokurimit KEK-20-778-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-"KEK" sh.a., duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 54 dhe 59 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, nenin 44.6 të RRUOPP-së, si dhe Rregullorja 02/2017

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 11.11.2020, ka autorizuar ekspertin teknik të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti teknik i prokurimit në raportin e dt: 13.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:
Pretendimi ankimor ka të bëjë me eliminimin e OE ankues: Ne, "ORA Engineering", pas shqyrtimit të Njoftimit mbi vendimin e AK-së më datë: 28.10.2020, për shpalljen e ofertës tonë si të papërgjegjshme në aspektin financiar duke pretenduar se oferta jone ka tejkaluar buxhetin në mënyrë substanciale (rreth 4%), ne si OE, nuk pajtohemi për vendimin e AK-së për arsyet si më poshtë sepse paraprakisht në rastin e vlerësimit të parë më datë: 03.06.2020 dhe rivlerësimit më datë: 10.07.2020 kemi pranuar letër standarde të tenderuesit të suksesshëm, për më shumë referojuni tekstit të mëposhtëm:
Njoftim për vendimin e AK-se (përfshirë Letrat standarde) më datë: 03.06.2020.
Njoftim për vendimin e AK-se (përfshirë Letrat standarde të pasuksesshme) më datë: 10.07.2020
Eksperti shqyrtues sqaron se Autoriteti kontraktues konform vendimit te OSHP-së me nr. 524/20 dt.:17.09.2020 ka kthyer këtë aktivitet ne Ri-vlerësim, komisioni i vlerësimit të AK-së ka bërë vlerësimin e ofertave mbi bazën e kritereve të dhëna në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë. Vlera e parashikuar për këtë aktivitet të prokurimit është: 45,000.00€, ndërsa vlera e ofertës e operatorit ekonomik ankues është: 47,021.00€.
Autoriteti kontraktues me datë 28.10.2020 njofton operatorin ekonomik ankues përmes Letrës standarde të tenderuesit të eliminuar apo të papërgjegjshëm - se oferta juaj është e përgjegjshëm por ka tejkaluar buxhetin

e parapare për këtë aktivitet.

KEK

NJOFTIM

Korporata Energjetike e Kosovës sh.a.
Zyra Ekzekutive e Prokurimit
rr. Nëna Terezë nr 36
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

" ORA Engineering " SH.P.K., Mujë Krasniqi C7,K1/5, -, Prishtinë,

Nr i prokurimit	KEK-20-778-1-2-1
Nr i brendshëm	KEKO-20-103-121

Titulli: FURNIZIMI PJES REZERV PER MRRK

I nderuar,

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kritereve të dhëna në Njoftimin për Kontratë dhe ne Dosjen e Tenderit.

Me keqardhje ju njoftojmë se tenderi i paraqitur nga ana juaj nuk qe i suksesshëm, ngase tenderi juaj (e tejkalon buxhetin për këtë tender) edhe pse i plotësonin kërkesat e dhëna në njoftimin e kontratës dhe ne dosjen e tenderit.

Ju informojmë se vlera financiare e ofertës tuaj substancialisht e tejkalon buxhetin e parashikuar nga Autoriteti Kontraktues për këtë aktivitet të Prokurimit (Vlera e ofertës 47.021,00 Euro ndërsa vlera e parashikuar 45,000.00 Euro)

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.
Dhënia e kontratës është e përkohshme dhe nuk përbën një marrëveshje kontraktuale deri në skadimin e intervalit, gjatë të cilit ofertuesit e pasuksesshëm mund të kërkojnë shqyrtimin e vendimit.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do te vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme te prokurimit .

Me respekt,
Zyra Ekzekutive e Prokurimit KEK sh.a.

Prandaj, për t'i përdorë këto fonde në mënyrë ekonomike siç e parasheh LPP-së, Autoriteti kontraktues është dashur të pranoje oferta me çmime më të ulëta dhe çmime të tregut të cilat do të mundësonin realizimin e kontratës në vlerën e parashikuar financiare. Andaj, anulimi i aktiviteti të prokurimit është bërë për shkak të buxhetit të pa mjaftueshëm të autoritetit kontraktues në raport me ofertën e Operatorit ekonomik ankues. Prandaj, pretendimi ankimor i OE ankues është i pa bazuar.

Pretendimi ankimorë i dytë ka të bëjë me: Në rastin e rivlerësimit AK-ja më datë: 28.10.2020 ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-se ku rekomandohet që procedura e prokurimit të anulohet në mungesë të ofertave të përgjegjshme përfshirë OE "ATM Engineering" si të papërgjegjshëm pasi që nuk ka arritur të dokumentoj pas sqarimeve shtesë nga AK-ja se dokumentet e dorëzuara "Katalogu dhe certifikata ISO 9001" janë në pajtim me kërkesat e dosjes së tenderit siç është në vendimin e OSHP-së të datës 17.09.2020.

Ekspert shqyrtues, Komisioni për rivlerësim konform Vendimit të OSHP-së me numër 524/20 e datës 17.09.2020 ka bërë rivlerësimin e ofertave duke u bazuar në vendim dhe rekomandimin e Panelit shqyrtues që AK-ja të respektoj nenin 1 dhe 6 të LPP-së, duke kërkuar sqarime shtesë për dokument e prodhuesit të ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë në përputhje me nenin 59 dhe 72 të LPP-së, t'i sqarojë dokumente e dorëzuara nga prodhuesi "Katalogët dhe certifikatën ISO". Citoj:

Sqarimi : Komisioni i vlerësim bazuar ne sqarimet qe janë dhënë për pozicionin me numër katër(4) ku në

Vendim kërkohet që të sqarohet nga komisioni për rivlerësim komfor nenit 72 që të kërkohet nga përfaqësuesi i prodhuesi për produktin e ofruar që të japin sqarime se a është produkt i njëjtë nga prodhuesi IMI CCI, dhe ka kërkuar sqarime ku kemi marrë përgjigje.

Përgjigje: - Përshkrimi teknik që i kemi dorëzuar ATM-PR është dhënë me qëllim të vlerësimit teknik, por asnjëherë nuk kemi dorëzuar një ofertë zyrtare për produktin e kërkuar nga IMI-CCI, sepse agjenti zyrtar i IMI në Beograd na informoi se nuk është në gjendje të na ofrojë një ofertë për pajisjet e kërkuara. Në përputhje me sa më sipër, ne dëshirojmë t'ju informojmë se nuk kemi dorëzuar një ofertë në ATM-PR për produktin e kërkuar.

Andaj, bazuar në përgjigjen e prodhuesit lidhur me "Katalogët dhe certifikatën ISO" ku njofton se nuk kanë dorëzuar ofertë për ATM-PR për produktet e kërkuar, autoriteti kontraktues me dt. 28.10.2020 përmes Letrës standarde të tenderuesit të eliminuar apo te papërgjegjshëm njofton operatorin ekonomik të rekomanduar për kontratë se është i papërgjegjshëm. Pretendimi ankimore i operatorit ekonomik ankues është i bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lart përmendura, eksperti shqyrtues/teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK-së, dhe nëse shpreh interesim për të vazhduar më këtë aktivitet të prokurimit, të njëjtin mund të Ritenderoj.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 16.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë: 19.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pjesërisht pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues, duke sqaruar:

Ju informojmë se ne nuk pajtohemi me ekspertizën Nr. 918/20 të datës 16.11.2020 që ka të bëjë me aktivitetin me numër të prokurimit: KEK-20-778-1-2-1- Furnizimi me pjese rezervë për MRK. Arsyeje se pse ne nuk pajtohemi me ekspertizën janë:

Eksperti teknik/shqyrtues nuk ka bërë trajtimin e të gjitha pretendimeve ankimore të cilat i kemi paraqitur më datë:10.11.2020 në ankesën tonë për këtë aktivitet te prokurimit sepse siç shihet ne përgjigjet e ekspertit shqyrtues ku ka shqyrtuar pjesërisht pretendimet tona. Siç shihet në raport në përgjigjen e ekspertit shqyrtues i cili ka ofruar përgjigje vetëm për njoftimin e datës 28.10.2020 (Njoftim- Oferta financiare ka tejkaluar buxhetin e parashikuar nga AK) dhe Katalogun dhe Certifikatën 1SO900I qe OE i rekomanduar për kontrate nuk i ka plotësuar. Eksperti shqyrtues nuk ka analizuar dhe shqyrtuar pretendimet tjera ankimore për këtë aktivitet te prokurimit ku ne rastin e vlerësimit dhe rivlerësimit nuk jemi eliminuar nga AK KEK për tejkalim të buxhetit të parashikuar nga AK. Dëshmia më e mirë konform procedurave të prokurimit është pranimi nga AK-ja e të dy letrave standarde të datës 03.06.2020 dhe 10.07.2020 ku nuk është cekur se oferta jonë

eliminohet për tejkalim të buxhetit. Sipas procedurave të prokurimit dhe vlerësimit standard në rast se AK nuk është pajtuar me ofertën tonë financiare të tejkalimit të buxhetit është dashur që në dy vlerësimet paraprake përmes letrave standarde të ceket se oferta jonë refuzohet për shkak të tejkalimit të buxhetit të parashikuar që në këtë rast nuk ka ndodhur.
Referuar Raportit të ekspertizës të ekspertit teknik dhe rivlerësimit nga AK-ja është shumë e qartë se oferta jone vlerësohet me dy standarde te ndryshme dhe kjo është në kundërshtim me Nenin 7 dhe 59 të LPP-së.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 23.11.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulimin e aktiviteti të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit teknik dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Ora Engineering" SH.P.K. – Prishtinë, se AK e ka shpallur si të papërgjegjshëm në aspektin financiar për shkak se ka tejkaluar buxhetin në mënyrë substanciale (rreth 4%), ku vlera e parashikuar për këtë aktivitet të prokurimit është 45,000.00€, ndërsa vlera e ofertës së operatorit ekonomik ankues është 47,021.00€. Autoriteti kontraktues me datë 28.10.2020 njofton operatorin ekonomik ankues përmes Letrës standarde të tenderuesit të eliminuar apo të papërgjegjshëm - se oferta juaj është e përgjegjshëm por ka tejkaluar buxhetin e parapare për këtë aktivitet.
Paneli Shqyrtues sqaron se pas vlerësimit dhe rivlerësimit të AK-së, OE ankues nuk është eliminuar nga AK për tejkalim të buxhetit të parashikuar nga AK. Këtë e dëshmon AK-ja në të dy letrat standarde të datës 03.06.2020 dhe 10.07.2020, ku nuk është cekur se oferta e OE ankues eliminohet për tejkalim të buxhetit. Nëse, AK vlerëson se tenderi i OE ankues refuzohet për shkak të tejkalimit të buxhetit të parashikuar, atëherë pse në dy vlerësimet paraprake përmes letrave standarde nuk është cekur se tenderi i OE ankues refuzohet për shkak të tejkalimit të buxhetit të parashikuar. Andaj, Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të këtij pretendimi ankimor vlerëson se ky pretendim ankimor është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e dytë të OE ankues "Ora Engineering" SH.P.K. – Prishtinë, se AK e ka eliminuar me arsyetimin që procedura e prokurimit të anulohet në mungesë të ofertave të përgjegjshme përfshirë OE "ATM Engineering" si të papërgjegjshëm pasi që nuk ka arritur të dokumentoj pas sqarimeve shtesë nga AK-ja se dokumentet e dorëzuara "Katalogu dhe certifikata ISO 9001" janë në pajtim me kërkesat e dosjes së tenderit siç është në vendimin e OSHP-së të datës 17.09.2020.
Paneli Shqyrtues sqaron se komisioni për rivlerësim konform Vendimit të OSHP-së me numër 524/20 e

datës 17.09.2020 ka bërë rivlerësimin e ofertave duke u bazuar në vendim dhe rekomandimin e Panelit shqyrtues që AK-ja të respektoj nenin 1 dhe 6 të LPP-së, duke kërkuar sqarime shtesë për dokument e prodhuesit të ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë në përputhje me nenin 59 dhe 72 të LPP-së, t'i sqarojë dokumente e dorëzuara nga prodhuesi "Katalogët dhe certifikatën ISO". Bazuar në përgjigjen e prodhuesit lidhur me "Katalogët dhe certifikatën ISO" ku njofton se nuk kanë dorëzuar ofertë për ATM-PR për produktet e kërkuar, autoriteti kontraktues me dt. 28.10.2020 përmes Letrës standarde të tenderuesit të eliminuar apo te papërgjegjshëm njofton operatorin ekonomik të rekomanduar për kontratë se është i papërgjegjshëm. Pretendimi ankimor i operatorit ekonomik ankues është i bazuar.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, vjen në përfundim se anulimi i aktiviteti të prokurimit me arsyetimin se ka tejkalim të buxhetit për këtë aktivitet të prokurimit nuk është arsye për eliminim të OE ankues dhe nuk është arsye për anulimin e aktivitetit të prokurimit. Andaj, obligohet AK që të vazhdoj me procedurën e prokurimit për këtë aktivitet duke bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit dhe në harmoni me nenin 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi Paçarizi

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK KEK sh.a.;

1x1 OE "Ora Engineering" SH.P.K. – Prishtinë;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.